

100 VJETORI I INSTITUTIT KOMBËTAR TË SHËNDETËSISË PUBLIKE TË KOSOVËS



Pleurat Sejdiu

Kryetar i Odës së Mjekëve të Kosovës

*Specialist i Ortopedisë,
Qendra Klinike Universitare e Kosovës.*

100 vjetori i Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKSHPK) është jo vetëm një jubile i rëndësishëm festiv, por edhe një moment reflektimi mbi rrugëtimin e jashtëzakonshëm të mjekësisë preventive, respektivisht shëndetit publik në vendin tonë. Për një shekull me rradhë, IKSHPK ka qenë pararojë në luftën kundër sëmundjeve ngjyese dhe jo-ngjyese, në edukimin shëndetësor të popullatës, në sigurimin e vaksinimit sistematik, dhe në ballafaqimin me sfida gjithnjë e më komplekse, përfshirë epidemi dhe pandemi që lanë gjurmë.

Roli i këtij institucioni u dëshmuar fuqishëm edhe gjatë pandemisë COVID-19, ku me profesionalizëm dhe sakrificë, ekspertët e shëndetit publik, në bashkëpunim edhe me profesionistët e fushave të tjera, përfshirë ata të kujdesit primar dhe të trajtimit klinik e spitalor, u vunë në vijën e parë të mbrojtjes së jetës së qytetarëve. Reagimi i koordinuar në detektimin e rasteve, gjurmimin epidemiologjik, testimin laboratorik, menaxhimin e të dhënave, informimin dhe edukimin e popullatës bazuar në dëshmi shkencore, janë shembuj të kontributit që do të mbetet në histori si dëshmi e pjekurisë sonë profesionale për t'u ballafaquar me emergjencat e shëndetit publik.

Sot, shëndeti publik ka nevojë të forcohet, të mbështetet dhe të modernizohet për t'u përshatur sfidave të reja: rreziqeve që ndërlihen me qarkullimin e shpejtë të patogjenëve, rikthimin e sëmundjeve që konsideroheshin pothuaj të eradikuara, rritjes së barrës nga sëmundjet kronike, veçanërisht sëmundjeve malinje dhe atyre kardiovaskulare, globalizimit të rreziqeve dhe faktorëve që lidhen me stilin e jetesës. Kjo kërkon që vendimmarrja politike të mbështes institucionet shëndetësore dhe arsimore që të investojnë në përgatitjen e kuadrove të reja, në motivimin e ekspertëve aktualë dhe në krijimin e kushteve të dinjitetshme për ata që mbrojnë shëndetin kolektiv.

Oda e Mjekëve të Kosovës mbetet një partner i palëkundur i Institutit dhe gjithë profesionistëve të shëndetit publik. Ne njohim dhe vlerësojmë thellësisht kontributin që ky sektor ka dhënë dhe vazhdon të japë në sigurinë shëndetësore të vendit, dhe jemi të bindur se me bashkëpunim ndërinstitutional dhe përkushtim profesional, mund të përballojmë sfidat e së ardhmes. Duke njohur e respektuar, në të njëjtën kohë, përgjegjësitë dhe rolin e njëri-tjetrit.

Në emër të Odës së Mjekëve të Kosovës, i shprehim urimet më të përzemërta IKSHPK-së për 100-vjetorin, me mirënjohje për të kaluarën dhe njerëzit që kontribuan për një shekull dhe me vendosmëri për të ardhmen.

Korrespondenca:
pleurat.sejdiu@omk-rks.org